



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:114057

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05263556

P.nr.1995/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Dibran Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit E.LI., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.1 të KPRK-ës, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrit ndëshkimor me numër PP.II.nr.3226/23, të datës 19.05.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor me datë 31.01.2024 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP.II.nr.3226/23, të datës 19.05.2023, andaj gjykata komfor dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: E.LI., nga babai H. dhe nëna H., e gjinisë M., i lindur me datë, nëj e madhe, me vendbanim në fshatin, i divorcuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 22.04.2023, rreth orës 23:50, i akuzuari nëpërmjet telefonit e me qëllim të frikësimit se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe, e ka thirrur në telefon tani të dëmtuarit – E. H., ku në bisedë e sipër i akuzuari e kishte kanosur seriozisht duke i'u drejtuar me fjalët "a del ti sonte unë te njoh shumë mirë veç sa takohemi se kam met vra" me ç'rast tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë dhe ankth për jetë.

- Me këtë ka kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-ës

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së si dhe neni 495 të KPP-së të pandehurin e lartcekur:

DËNIM ME GJOBË

I. Në shumën prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë komfor neni 43 par.3 të KPRK-së dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës, do t'i caktohet 1 (një) ditë burgim.

I. Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro), si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.3226/23, të datës 19.05.2023, kundër të pandehurit E.Ll., për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par. 1 të KPRK-ës dhe njëherit ka propozuar që ndaj të njëjtit të jepet Urdhër Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesë për dhënie e urdhrin ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPP-së për dhënie e urdhrin ndëshkimor dhe komfor neni 495 paragrafi 1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkangjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë: raporti i policisë

i dt. 24.04.2023, deklarata e të dëmtuarit e dt. 23.04.2023, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të bashkangjitura në lëndë dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë ashtu siç është propozuar nga prokurori i shtetit në kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPKR-ës.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor komfor nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP-së ndërkaq vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1995/2023, me datë 31.01.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.